

KËRKESË
Nr. 825/6, datë 9.7.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, ‘Rikonstruksion rruge, fshati Drenovicë, Bashkia Dimal’.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Dimal.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “truall”, bazuar në VKM- në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, si dhe për pasuritë e llojit “ndërtesë”, bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit ‘ndërtesë’”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Dimal, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është **1,750,494 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekë.**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “RIKONSTRUKSION RRUGE, FSHATI DRENOVICË”

NR.	P R O N A R I			TË DHËNA HIPOTEKORE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM										S H È N I M E (Kufizime hipotekore, barre mbi pasurinë etj.)	SEKSIONI D	SEKSIONI E
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadasra- le	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja a Totale	"Ag" (m2)	"Trrall" (m2)	"Ndërrës g" (m2)	Volumi	Faqe	"ARË"			"TRUALL"			"NDËRTESE"			VLERA TOTALE (leke)			
														Sipërfaqja a (m2)	Çmimi (leke/m2)	Vlera (leke)	Sipërfaqja a (m2)	Çmimi (leke/m2)	Vlera (leke)	Sipërfaqja a (m2)	Çmimi (leke/m2)	Vlera (leke)				
	A	B	C	C	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	Y	Z		
1	Xhezmi	Ali	Sulovari	Kutalli	2349	45/7	Trruall	84		84	84	8	44			0	84	203	17,052	84		1,733,442	1,750,494			
	SHUMA TOTALE																	17,052			1,733,442	1,750,494				